



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Abedin Kerrnaja** më datë **11.11.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Zëvendësimin e masës së sigurimit personal *“Arrest në shtëpi”*, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar me Vendimin nr. 112, datë 06.09.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me një masë më të lehtë”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Etleva Deda, bazuar në nenet 246 pika 6 dhe 260 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr. **642**, datë **27.11.2024**, vendosi:

1. Rrëzimin e kërkesës së kërkuesit/personit nën hetim **Abedin Kerrnaja**, me objekt: *“Zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale, caktuar ndaj tij me Vendimin nr. 112, datë 06.09.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me një masë më të lehtë.”*, si të pambështetur në ligj dhe prova.
2. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkuesit.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda afatit ligjor në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë 27.11.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar